

Gjykata Supreme e Kosovës, kolegji i përberë nga gjyqtaret: Enver Peci, kryetar, Erdogan Haxhibeqiri dhe Emine Kaçiku anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, si procesmbajtës, në konfliktin administrativ të paditësit S. L., nga Komuna e Lipjanit, kundër të paditurës Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPM SHCK), Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të paditësit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA.nr.176/2016 të datës 11.07.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 22.02.2017, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

APROVOHET si e bazuar kërkesa e paditësit, S. L., nga Komuna e Lipjanit, për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe anulohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, AA.nr.176/2016 të datës 11.07.2016, si dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, A.nr. 1367/2013 datë 13.04.2016, kurse lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

## A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, AA.nr.176/2016 të datës 11.07.2016 është refuzuar si e pa bazuar ankesa e të paditësit S. L., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, A.nr. 1367/13 datë 13.04.2016 është vërtetuar.

Paditësi kësaj gjykate në afat ligjor i ka parashtrua kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësorë, me të cilën në tërësi e konteston ligjshmërinë e aktgjykimit të atakuar për shkak të; shkeljes thelbësore të dispozitave procedurale si dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale me propozim që duke aprovuar kërkesën gjykata t'i; ndryshoj aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta, pastaj të anulohet vendimi

i të paditurës dhe vendimi i ZKAK në SZKSH, njashu që të anulohet në tërësi vendimi i radhitjes përfundimtare i Komisionit Përzgjedhës në këtë procedurë të rekrutimit për pozitën Zyrtar Ligjor në Prokurorin Themelore në Prishtinë, duke detyruar SZKSH që, pas pranimit të aktgjykimit t'i ndërmarrë të gjitha veprimet administrative me qëllim të zbatimit të tij, me detyrim që të rifilloj procedurën e rekrutimit për pozitën e cekur.

Gjykata Supreme e Kosovës në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktvendimit të atakuar, kërkesës së paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësorë dhe shqyrtimit të shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Kërkese është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Sekretariati i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Zyra e Burimeve Njerëzore, në Prishtinë më datë 21.02.2013, ka shpallur konkurs për disa pozita për prokurori themelore në vende të ndryshme, në mesin e të cilave edhe katër (4) pozita, Zyrtar ligjor në Prokurorin Themelore në Prishtinë (PTHP). Në konkursin e shpallur paditësi ka aplikuar në pozitat Zyrtar Ligjor dhe referent në Prokurorin Themelore në Ferizaj edhe në pozitën, Zyrtar Ligjor në PTHP-ës, pasi që nuk është përzgjedhur në listën e ngushtë të kandidatëve në PTHP, ka ushtrua ankesë Komisionit për zgjidhjen e ankesave në organin punëdhënës, me ç'rast i njëjti në bazë të vendimit nr. 947 të datës 27.08.2013, e ka refuzuar ankesën e paditësit si të pabazuar. Kundër këtij vendimi paditësi ka paraqitur ankesë të paditurës, e cila me vendimin nr.2575/13 datë 20.09.2013, e refuzon të njëjtën si të pabazuar ndërsa e ka lënë në fuqi vendimin e punëdhënësit. Paditësi kundër këtij vendimi përfundimtar të paditurës me padi inicon konflikt administrativ. Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin A.nr.1367/13 dt.13.04.2016, e refuzon si të pa bazë kërkesëpadinë e paditësit, ndërsa Gjykata e Apelit në Prishtinë, me aktgjykimin AA.nr.176/2016 të datës 11.07.2016, ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e paditësit ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkalles së parë e vërteton.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke vlerësuar pretendimet e paditësit rreth shkeljeve thelbësore të dispozitave procedurale, konstatoj se të njëjtat janë të bazuara. Kësisoj, gjykata konstatoj se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkalles së dytë por edhe i

shkalles së parë janë marre me shkelje thelbësore të dispozitave procedurale nga neni 182.1. pika n), të LPK-ës, të aplikueshme sipas nenit 63 LKA-ës, nga se të njëjtit nuk përmbajnë arsye të mjaftueshme për fakte vendimtare dhe se ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet me përmbajtje të provave në shkresat e lëndës. Në të vërtet nga shkresat e lëndës vërtetohet se paditësi në konkursin e shpallur nga SZKPSH-ës- Zyra e Burimeve Njerëzore në Prishtinë, aplikon në tri pozitat e shpallura në të njëjtën ditë, fakt që pranohet edhe nga komisioni për zgjedhjen e kontesteve dhe ankesave SZKSH në vendimin e kontestuar KA.nr.07/2013 dt. 26.08.2013. Me këtë rast KP e ka ftuar në rrethin e ngushtë të kandidatëve për PTHF, ndërsa për pozitën e Zyrtarit ligjor në PTHP nuk ftohet, me arsyetim se nuk e ka përvojën e punës njëvjeçare të kërkuar sipas konkursit. Përkundër këtyre fakteve gjykatat e instancave më të ulëta në aktgjykimet e kontestuara nuk kanë dhënë fare arsye për të cilat vazhdimisht ka pretenduar paditësi, kështu që arsyet e aktgjyqimeve për këto fakte vendimtare mbetën të mangëta. Në shkresat e lëndës konstatohet se paditësi ka prezantua prova për përvojën e punës të kërkuara sipas konkursit të cilat i ka deponuar në fotokopje për tri pozitat e shpallura në konkurs, mirëpo të njëjtat nuk janë vlerësuar respektivisht aktgjykimet nuk përmbajnë arsye, ndërsa aktgjykimet e atakuara bazohen ekskluzivisht nga provat dhe të dhënat nga organi administrativ aktet e të cilave janë kontestuar nga paditësi.

Sa i përket shkeljeve të drejtës materiale, kolegji i kësaj gjykate konstaton se pretendimet e paditësit janë të bazuara. Në të vërtet konstatohet se gjykatat gabimisht kanë zbatuar dispozitat ligjore të drejtës materiale e që konsistojnë në mbarëvajtjen e procesit rekrutues sipas Rregullores nr. 02/2010 Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil (PRSHC). Në të vërtet eliminimi i paditësit nga konkurrenca në mungesë siç ceket në aktgjykimet e atakuara se “ aplikacionit nuk i është bashkangjitur përvoja e punës “, duke pas parasysh faktin se paditësi për pozitën në PTHF me të njëjtat dokumente i ka plotësuar kushtet dhe ka poseduar përvojën e punës, për këtë gjykatë është e pa vërtetuar drejt gjendja faktike e cila drejtpërdrejt ka ndikuar në zbatimin e gabuar të drejtës materiale, duke u nis nga fakt i pa kontestueshëm se aplikacioni për secilën pozitë është dorëzuar në organin administrativ në SZKSHK. Gjithashtu nuk janë vlerësuar pretendimet e paditësit sa i përket shkeljeve tjera të rregullores në fjalë e që konsistojnë në nenin 23, të regjistrimi i aplikacioneve, afatet e përcaktuara gjithnjë sipas rregullores të përgatitjes së listës së shkurtër siç parashihet me nenin 26, pastaj neni 31, njoftimi i kandidateve të listës së ngushtë si dhe neni 32, testimi i kandidateve.

Duke vlerësuar arsytrat e mësipërme, Gjykata Supreme e Kosovës nuk mundë të pranoj si të drejtë qëndrimin juridik të Gjykatës së Apelit në Prishtinë dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, sa i përket aktgjykimeve të kontestuar, për shkak se të njëjti janë përfshirë me shkelej substanciale të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore i aplikueshëm sipas nenit 63 te LKA –ës, të cilat shkelje drejtpërdrejt kanë pas ndikim në marrjen e vendimit të ligjshëm, si dhe te aplikimit të gabuar të drejtës materiale, andaj aktgjykimet e atakuara doemos është dashur të anulohen.

Gjykata e shkallës së parë ka për detyrë që, në procedurën e përsëritur, të mënjanoj të metat e sipërpërmendura, ashtu që së pari duhet të sqaroj nga organi administrativ përmes të paditurës faktet se paditësi për pozitat për të cilat ka aplikua a i ka dërguar aplikacionet në vendin e njëjtë, pastaj t'i arsyetoj rrethanat se paditësi a i ka plotësua kushtet formale të konkursit në njërën nga pozitat për të cilat ka aplikuar, pastaj lidhur me këto të dhëna të jap arsye të qarta për eliminimin e paditësit nga lista e ngushtë. Gjithashtu gjykatat e instancave më të ulëta duhet të japin arsye të qarta rreth mbarëvajtjes së procesit rekrutues siç pretendon paditësi, duke u bazuar në Rregulloren 02/ 2010 PRSHC, në mënyrë që pas administrimit të provave në shkresat e lëndës dhe varësisht nga gjendja faktike e vërtetuar, me zbatimin adekuat të së drejtës materiale të vendos rreth kësaj çështje juridike-administrative, në mënyrë që të marr vendim të drejtë dhe të bazuar ne ligje.

Nga sa u tha me sipër, Gjykata Supreme e Kosovës me zbatimin e nenit 54 par.2 dhe 3 te Ligjit për Konflikte Administrative vendosi sikur në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Më 22 shkurt 2017, ARJ.nr.30/2016

Procesmbajtësi,  
Sherif Krasniqi

Kryetari i kolegjit,  
Enver Peci

